

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Azilkërkuesit e kthyer nga Britania në Francë denoncojnë dhu*ë, "The Guardian": Probleme të rënda shë ndetësore - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/azilkerkuesit-e-kthyer-nga-britania-ne-france-denoncojne-dhue-the-guardian-probleme-te-renda-shendetesore/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:34:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 18:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	28f2856dfc0ec44316e9ebf2524b4cb7955cdf88f198940ee2b430940cdb0ca9
TEKSTI	bae62face29873e5826d8bf0fa097e026035137dae1586a388567aa8bde1dd16
PAMJA	9af12db72a9133ff1504f9beb04da8376d916e2a3e85bbeb9b65a41ab637fdff

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7be5f3ec0cab03df6d1056910be83da193c543bf2f134bc555944e14419a79f3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7be5f3ec0cab03df6d1056910be83da193c543bf2f134bc555944e14419a79f3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Azilkerkuesit e kthyer nga Britania në Francë denoncojnë dhu*ë, "The Guardian": Probleme të rënda shëndetësore

BOTË

Demo

Azilkerkuesit e kthyer nga Britania në Francë denoncojnë dhu*ë, "The Guardian": Probleme të rënda shëndetësore

SEPTEMBER 14, 2026



Mavijosje, fraktura dhe dëmtime të tjera fizike e psikologjike janë dokumentuar te azilkerkuesit e kthyer nga Mbretëria e Bashkuar në Francë në kuadër të skemës kontroverse "një brenda, një jashtë", sipas të dhënave të mbledhura nga një shërbim shëndetësor francez.

Sipas "The Guardian", Samusocial de Paris ka dokumentuar 90 persona të kthyer në Francë nga Britania e Madhe mes 22 janarit dhe 7 qershorit 2026. Raporti evidenton raste me shenja që përputhen me dhunë fizike dhe psikologjike, ndërsa disa prej azilkerkuesve kanë pasur nevojë për trajtim spitalor ose psikiatrik.

Të gjithë personat e përfshirë në të dhënat e raportit janë burra të rinj, kryesisht në të 20-at dhe fillim të të 30-ave. Ata vijnë kryesisht nga vende të prekura nga luftërat dhe persekutimi, përfshirë Eritrenë, Sudanin dhe Afganistanin.

Skema "një brenda, një jashtë" parashikon që një azilkerkues që ka kaluar Kanalin Anglez me një varkë të vogël të kthehet në Francë, ndërsa në këmbim një person tjetër që ndodhet në Francë mund të transferohet ligjërisht në Mbretërinë e Bashkuar për të kërkuar azil. Programi pilot, i cili ka shkaktuar debate të forta politike dhe humanitare, pritet të përfundojë më 1 tetor.

Samusocial de Paris është ngarkuar nga autoritetet shëndetësore të rajonit Île-de-France që t'u ofrojë kujdes personave të kthyer nga Britania gjatë tetë ditëve të para pas deportimit, pasi ata vendosen në një qendër strehimi në Paris.

Raporti shëndetësor thotë se gjatë konsultimeve janë konstatuar shenja në përputhje me dhunën fizike dhe psikologjike, si dhe probleme të lidhura me qëndrimin e zgjatur në paraburgim dhe kushtet që personat i kanë përshkruar si degraduese.

Një prej rasteve më të rënda lidhet me një azilkerkues që u dërgua në urgjencë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Në dokumentacionin mjekësor përmenden mavijosje të shumta, dëmtime që përputhen me shtrëngimin nga prangat dhe dhimbje abdominale. Sipas dëshmisë së tij, dhimbjet ishin shkaktuar nga goditje të përsëritura.

Raporti përfshin gjithashtu 13 raste të dokumentuara në mënyrë më të detajuar, ku janë evidentuar lëndime fizike, probleme shëndetësore të përkeqësuar nga mungesa e trajtimit gjatë paraburgimit në Britani, si dhe çrregullime të shëndetit mendor.

Në një tjetër rast, një burrë u referua për trajtim urgjent psikiatrik pasi u shfaq i çorientuar dhe nuk ishte në gjendje të gjente rrugën për në konviktin ku ishte akomoduar.

Shërbimi shëndetësor francez ngre shqetësimin se personat e kthyer mund të kenë akses të kufizuar

Postimet e reja

Azilkerkuesit e kthyer nga Britania në Francë...

SEPTEMBER 14, 2026

Kardinali Ernest Simoni kremton në Virxhinia,...

SEPTEMBER 14, 2026

Përfundon gjykimi në Hagë, mbrojtja kërkon...

SEPTEMBER 14, 2026

"Jemi përpara Kinës", Trump sulmon CEO-n e...

SEPTEMBER 14, 2026

Mos e humb

AKTUALITET | SEPTEMBER 14, 2026

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Vitin e kaluar lute në Shqipëri pagoi 1.1 miliardë lekë ose 11.4 milionë euro shpenzime...

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfutjesit, qokat dhe "problematikët"

Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatrat të tërë me ndotje

Na ndiq

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

në trajtim të vazhdueshëm psikiatrik pasi rikthehen në Francë, duke rritur rrezikun që problemet e tyre shëndetësore të mos trajtohen në mënyrë të përshtatshme.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme britanike, rreth 1,400 persona janë kthyer me forcë në Francë që prej nisjes së skemës në gusht 2025. Disa prej tyre më pas kanë tentuar të rikthehen në Mbretërinë e Bashkuar, përmes kamionëve ose duke përdorur sërish varka të vogla për të kaluar Kanalin Anglez.

Gjetjet e Samusocial de Paris i janë paraqitur një hetimi ndërpartiak të Asamblesë Kombëtare franceze mbi ndikimin e marrëveshjeve kufitare mes Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar, të njohura si marrëveshjet e Le Touquet.

Raporti rekomandon krijimin e një mekanizmi të posaçëm për regjistrimin, hetimin dhe ndjekjen e akuzave për keqtrajtim nga autoritetet britanike. Gjithashtu, ai sugjeron që raste të tilla t'i raportohen prokurorit francez, në përputhje me nenin 40 të Kodit francez të Procedurës Penale.

Të dhënat e publikuara ngrënë pikëpyetje mbi mënyrën se si po zbatohet skema “një brenda, një jashtë” dhe mbi mbrojtjen shëndetësore dhe ligjore të personave që kthehen në Francë pas ndalimit në Mbretërinë e Bashkuar.

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja: Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.